

**LIGJ**  
**Nr. 41/2026**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN  
PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE TË KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA  
PËR TË DREJTËN E DETIT, TË 10 DHJETORIT 1982, QË LIDHEN ME RUAJTJEN  
DHE MENAXHIMIN E BURIMEVE PESHKORE NDËRKUFITARE  
DHE TË BURIMEVE SHUMËMIGRUESE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen për zbatimin e dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit, të 10 dhjetorit 1982, që lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese, bërë në *New York*, më 4.8.1995, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.4.2026.

**Shpallur me dekretin nr. 262, datë 30.4.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bajram Begaj**

**MARRËVESHJE**

**PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE TË KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA  
PËR TË DREJTËN E DETIT, TË 10 DHJETORIT 1982, QË LIDHEN ME RUAJTJEN DHE  
MENAXHIMIN E BURIMEVE PESHKORE NDËRKUFITARE DHE BURIMEVE PESHKORE  
SHUMËMIGRUES**

Shtetet palë të kësaj Marrëveshjeje,  
*referuar* dispozitave përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit, të datës 10 dhjetor 1982;

*të angazhuar* për sigurimin, ruajtjen afatgjatë dhe shfrytëzimin e vazhdueshëm të burimeve peshkore ndërkufitare dhe burimeve peshkore migruese;

*të angazhuar* për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet shteteve në këtë drejtim;

*duke kërkuar* zbatim më efektiv të masave për ruajtjen dhe menaxhimin e aprovuar të këtyre burimeve nga ana e shteteve të licencuara, atyre portuale dhe bregdetare;

*me qëllim* trajtimin specifik të problemeve të theksuara në kapitullin 17, programi C, Agjenda 21, miraturar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, më konkretisht, ngaqë menaxhimi i peshkimit në det të hapur është i pamjaftueshëm në shumë zona dhe se disa burime janë të mbishfrytëzuara;

*duke theksuar se* ka probleme të peshkimit të parregulluar, investimit të tepërt, madhësisë së madhe të flotës, regjistrimit të anijeve nën flamuj të tjerë për t'iu shmangur kontrolleve, përdorimit

të mjeteve të pamjaftueshme selektive, bazave të të dhënave të pasigurta dhe mungesës së bashkëpunimit të mjaftueshëm ndërmjet shteteve;

*duke u angazhuar* për një aktivitet peshkimi të frytshëm;

*të vetëdijshme* për nevojën për të shmangur ndikimet negative mbi mjedisin detar, për të ruajtur biodiversitetin, për të siguruar integritetin e ekosistemeve detare dhe për të minimizuar rrezikun e efekteve afatgjata ose të pariparueshme të aktivitetit të peshkimit;

*duke ditur* nevojën për ndihmë konkrete, përfshirë ndihmën financiare, shkencore dhe teknologjike, në mënyrë që shtetet në zhvillim të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive në ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese;

*të bindur se* marrëveshja për zbatimin e dispozitave përkatëse të Konventës do t'u shërbente dhe kontribuonte më së miri këtyre qëllimeve të ruajtjes e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare;

*duke premtuar se* çështjet që nuk rregullohen nga Konventa ose nga kjo Marrëveshje vazhdojnë të rregullohen nga ligjet dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme;

**kanë rënë dakord**, si më poshtë:

## PJESA I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet dhe fusha e zbatimit

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) fjala “Konventë” nënkupton Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit, të datës 10 dhjetor 1982;

b) “Masat për ruajtjen dhe menaxhimin” nënkuptojnë masat për të ruajtur dhe menaxhuar një ose më shumë specie të burimeve të gjalla detare, të cilat miratohen dhe zbatohen në përputhje me rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, siç pasqyrohen në Konventë dhe në këtë Marrëveshje;

c) në fjalën “Peshq” përfshihen molusqet dhe krustacet, përveç atyre që i përkasin specieve sedentare, sipas përcaktimit të bërë në nenin 77 të Konventës; dhe

a) me “Dakordësim” nënkuptohet mekanizmi bashkëpunues i krijuar në përputhje me Konventën dhe këtë Marrëveshje nga dy ose më shumë shtete, me qëllim, ndër të tjera, të vendosjes së masave për ruajtjen dhe menaxhimin në një nënrajon ose rajon të një ose më shumë burimeve peshkore ndërkufitare ose burimeve shumëmigruese.

2. a) “Shtete palë” nënkupton shtetet që kanë dhënë pëlqimin për të qenë të lidhura nga kjo Marrëveshje dhe për të cilat Marrëveshja është në fuqi.

b) Kjo Marrëveshje zbatohet në mënyrë reciproke:

i. për çdo subjekt të përmendur në nenin 305, paragrafi 1(c), (d) dhe (e) të Konventës; dhe

ii. sipas parashikimeve të nenit 47, për çdo subjekt që përmendet si “Organizatë ndërkombëtare” në aneksin IX, neni 1, të Konventës, e cila bëhet palë në këtë Marrëveshje, dhe në atë masë, termi “Shtetet palë” u referohet këtyre subjekteve.

3. Kjo Marrëveshje zbatohet në mënyrë reciproke edhe për entitete të tjera peshkimi, anijet e të cilave ushtrojnë peshkim në det të hapur.

### Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që të sigurojë ruajtjen afatgjatë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve të peshkut shumëmigrues, nëpërmjet zbatimit efektiv të dispozitave përkatëse të Konventës.

### Neni 3

## Zbatimi

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, kjo Marrëveshje zbatohet për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese përtej zonave të juridiksionit kombëtar, me përjashtim të neneve 6 dhe 7, të cilat zbatohen, gjithashtu, edhe për ruajtjen dhe menaxhimin e këtyre burimeve në zonat brenda juridiksionit kombëtar, duke respektuar rregullat e ndryshme juridike që zbatohen në zonat brenda juridiksionit kombëtar dhe në zonat përtej juridiksionit kombëtar, siç parashikohet nga Konventa.

2. Në ushtrimin e të drejtave sovrane për qëllime eksplorimi dhe shfrytëzimi, ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese në zonat brenda juridiksionit kombëtar, shteti bregdetar do të zbatojë *nëpërmjet* parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 5.

3. Shtetet duhet të marrin në konsideratë kapacitetet përkatëse të shteteve në zhvillim për të zbatuar nenet 5, 6 dhe 7, në zonat brenda juridiksionit kombëtar, si dhe nevojën e tyre për asistencë, siç parashikohet në këtë Marrëveshje. Për këtë qëllim, pjesa VII zbatohet në mënyrë reciproke për zonat brenda juridiksionit kombëtar.

### Neni 4

#### **Marrëdhënia midis kësaj Marrëveshjeje dhe Konventës**

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat, juridiksionin dhe detyrimet e shteteve të përcaktuara në Konventë. Kjo Marrëveshje do të interpretohet dhe zbatohet në kuadër dhe në përputhje me Konventën.

## PJESA II

### **RUAJTJA DHE MENAXHIMI I BURIMEVE PESHKORE NDËRKUFITARE DHE TË BURIMEVE PESHKORE SHUMËMIGRUESE**

### Neni 5

#### **Parimet e përgjithshme**

Për të ruajtur dhe menaxhuar burimet peshkore ndërkufitare dhe burimet shumëmigruese, shtetet bregdetare dhe shtetet që ushtrojnë peshkim në det të hapur, në zbatim të detyrimit të tyre për të bashkëpunuar, në përputhje me Konventën:

a) miratojnë masa për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve peshkore ndërkufitare dhe burimeve shumëmigruese dhe të promovojnë objektivin e shfrytëzimit optimal të këtyre burimeve;

b) sigurojnë që këto masa të bazohen në evidencat më të mira shkencore të disponueshme dhe të jenë të hartuara, me qëllim ruajtjen ose përmirësimin e rezervave peshkore në ato nivele që të japin rendimente maksimale të qëndrueshme, sipas faktorëve përkatës mjedisorë dhe ekonomikë, përfshirë kërkesat e veçanta të shteteve në zhvillim, si dhe duke pasur parasysh format e peshkimit, ndërvarësinë e burimeve peshkore dhe çdo standard minimal ndërkombëtar të rekomanduar në përgjithësi, qoftë në nivel nënrajonar, rajonal apo global;

c) zbatojnë metodat parandaluese, në përputhje me nenin 6;

d) vlerësojnë ndikimet e aktivitetit të peshkimit, të aktiviteteve të tjera njerëzore dhe të faktorëve mjedisorë mbi rezervat objekt peshkimi, dhe mbi speciet që i përkasin të njëjtit ekosistem ose që janë të lidhura me rezervat objekt peshkimi, ose varen prej tyre;

e) miratojnë, kur të jetë e nevojshme, masa për ruajtjen dhe menaxhimin e specieve që i përkasin të njëjtit ekosistem ose që janë të lidhura me rezervat objekt peshkimi, ose varen prej tyre, me synim ruajtjen ose përmirësimin e këtyre popullatave në ato nivele ku riprodhimi i tyre mund të jetë shumë i rrezikuar;

f) minimizojnë ndotjen, mbeturinat, hedhurinat, bllokimet nga veglat e humbura të peshkimit ose të braktisura, gjuetinë e specieve joobjekt peshkimi, qofshin peshq apo jo (më tej referuar si “specie joobjekt peshkimi”), si dhe ndikimet mbi speciet e lidhura ose të varura prej tyre, veçanërisht ato të rrezikuara, nëpërmjet masave që përfshijnë, sa është e zbatueshme, zhvillimin dhe përdorimin e veglave dhe teknikave të peshkimit selektiv, të sigurta për mjedisin dhe me shpenzime operative;

g) mbrojnë biodiversitetin në mjediset detare;

h) ndërmarrin masa për të ndaluar ose parandaluar mbi peshkimin dhe kapacitetet e peshkimit përtej limiteve, si dhe për të siguruar që niveli i sforcos të peshkimit të mos tejkalojnë përpjekjet e peshkimit në raport me shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore;

i) marrin në konsideratë interesat e peshkatarëve artizanale dhe të atyre që ushtrojnë aktivitetet peshkimi për mbijetesë;

j) grumbullojnë dhe shpërndajnë, në kohë, të dhëna të plota dhe të sakta mbi aktivitetet e peshkimit, duke përfshirë, ndër të tjera, pozicionin e anijeve, gjuetinë e specieve objekt dhe joobjekt peshkimi, si dhe sforcos e peshkimit, sipas përcaktimeve të shtojcës I, si edhe informacionin nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit;

k) promovojnë dhe zhvillojnë kërkimin shkencor dhe teknologjitë e përshtatshme në mbështetje të ruajtjes dhe menaxhimit të peshkimit; dhe

l) zbatojnë dhe sigurojnë respektimin e masave të ruajtjes dhe menaxhimit ndërmjet monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes efektive.

## Neni 6

### Zbatimi i metodës parandaluese

1. Shtetet duhet të zbatojnë gjerësisht metodat parandaluese për ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese, me qëllim mbrojtjen e burimeve të gjalla detare dhe ruajtjen e mjedisit detar.

2. Shtetet duhet të tregojnë kujdes të shtuar kur informacioni është i pasigurt, i vërtetë ose i pamjaftueshëm. Mungesa e informacionit shkencor nuk përdoret si arsye për të shtyrë ose për të mos ndërmarrë masa për ruajtjen dhe menaxhimin.

3. Në zbatimin e metodës parandaluese, shtetet duhet të:

a) përmirësojnë vendimmarrjen për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore, duke siguruar dhe shkëmbyer informacionin më të mirë shkencor të disponueshëm, si dhe duke zbatuar teknika të përmirësuara për menaxhimin e riskut dhe pasigurisë;

b) zbatojnë udhëzimet e shtojcës II dhe të përcaktojnë, mbi bazën e informacionit më të mirë shkencor të disponueshëm, pikat e referencës dhe masat për aktivizimin e rezervave kur këto pika tejkalohen;

c) marrin parasysh, ndër të tjera, pasiguritë që lidhen me madhësinë dhe shtimin e burimeve, pikat e referencës, gjendjen e resurseve në raport me këto pika reference, nivelet dhe shpërndarjen e ngordhjes nga peshkimi dhe ndikimin e aktiviteteve të peshkimit mbi speciet joobjekt peshkimi, të lidhura ose të varura prej tyre, si dhe kushtet detare, mjedisore dhe socio-ekonomike; dhe

d) zhvillojnë programe për grumbullimin e të dhënave dhe kërkimin shkencor, për të vlerësuar impaktin e peshkimit mbi speciet joobjekt peshkimi ose të varura prej tyre dhe mbi habitatet e veçanta, si dhe miratojnë planet që janë të nevojshme për të siguruar ruajtjen e këtyre specieve dhe për të mbrojtur habitatet sidomos ata të kërcënuar.

4. Shtetet duhet të marrin masa për t'u siguruar që, pikat e referencës të mos tejkalohen. Kur ato tejkalohen, ata do të ndërmarrin menjëherë masat e parashikuara në paragrafin 3(b).

5. Kur gjendja e rezervave ose e specieve joobjekt peshkimi është shqetësuese, shtetet duhet t'u nënshtrohen atyre rezervave me monitorim të shtuar dhe t'i rishikojnë masat e ruajtjes, dhe menaxhimit bazuar në informacionin e ri.

6. Për format e reja të peshkimit ose veprimtarive eksploruese, shtetet miratojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, masa të kujdesshme ruajtjeje dhe menaxhimi, përfshirë, ndër të tjera kufizime të gjuetive dhe sforcos së peshkimit. Këto masa do të mbeten në fuqi deri në grumbullimin e të dhënave

të mjaftueshme për vlerësimin e ndikimit të peshkimit mbi qëndrueshmërinë e rezervave, pas së cilës do të zbatohen masa të reja për ruajtjen dhe menaxhimin. Masat e mëvonshme, do të lejojnë, zhvillimin gradual të peshkimit kur të jetë e përshtatshme.

7. Kur një dukuri natyrore ndikon negativisht mbi burimet peshkore, shtetet miratojnë masa emergjente për ruajtjen dhe menaxhimin, për të shmangur përkeqësimin e situatës. Po kështu, ata miratojnë edhe masa emergjente kur aktiviteti i peshkimit kërcënon seriozisht qëndrueshmërinë e rezervave. Masat emergjente janë të përkohshme dhe bazohen në provat shkencore më të mira të disponueshme.

## Neni 7

### **Përputhshmëria e masave për ruajtjen dhe menaxhimin**

1. Pa cenuar të drejtat sovrane të shteteve bregdetare për qëllime të eksplorimit, shfrytëzimit, ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve të gjalla detare në zonat brenda juridiksionit kombëtar, siç parashikohet në Konventë, dhe të drejtën e të gjitha shteteve që shtetasit e tyre të ushtrojnë peshkim në det të hapur në përputhje me Konventën:

a) sa u përket burimeve peshkore ndërkufitare, shtetet bregdetare përkatëse dhe shtetasit e vendeve të të cilëve ushtrojnë aktivitet peshkimi për këto burime në zonën përreth deteve të hapura, do të përpiqen, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet mekanizmave të përshtatshëm të bashkëpunimit, të parashikuara në pjesën III, të bien dakord mbi masat e nevojshme për ruajtjen e këtyre burimeve në zonat përreth detit të hapur;

b) për sa u përket burimeve peshkore shumëmigruese, shtetet bregdetare përkatëse dhe shtetasit e shteteve të të cilëve ushtrojnë peshkim në këto burime të rajonit do të bashkëpunojnë, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet mekanizmave të përshtatshëm të bashkëpunimit, të parashikuar në pjesën III, me qëllim sigurimin e ruajtjes dhe çuarjes më tej të objektivit të shfrytëzimit optimal të këtyre burimeve në të gjithë rajonin, si brenda ashtu edhe përtej zonave brenda juridiksionit kombëtar.

2. Masat e marra për ruajtjen dhe menaxhimin e detit të hapur dhe ato të miratuara për zonat brenda juridiksionit kombëtar do të jenë të zbatueshme, me qëllim që të sigurohet ruajtja dhe menaxhimi i plotë i burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese. Për këtë qëllim, shtetet bregdetare dhe shtetet që ushtrojnë peshkim në det të hapur kanë detyrimin të bashkëpunojnë për të arritur masa të zbatueshme për këto burime. Në përcaktimin e masave të zbatueshme për ruajtjen dhe menaxhimin, shtetet duhet të:

a) marrin parasysh masat e miratuara dhe zbatuara në përputhje me nenin 61 të Konventës për ruajtjen dhe menaxhimin për të njëjtat burime nga shtetet bregdetare në zonat brenda juridiksionit kombëtar, dhe të sigurojnë që masat e vendosura për detin e hapur, në lidhje me këto burime, të mos cenojnë efektivitetin e këtyre masave;

b) marrin parasysh masat e dakordësuara më parë, të vendosura dhe të zbatuara për detet e hapura në përputhje me Konventën, në lidhje me të njëjtat burime, nga shtetet bregdetare përkatëse dhe shtetet që ushtrojnë peshkim në detet e hapura;

c) marrin parasysh masat e dakordësuara më parë, të vendosura dhe zbatuara në përputhje me Konventën, në lidhje me të njëjtat burime, me një organizatë ose dakordësim nënrajonal ose rajonal të menaxhimit të peshkimit;

d) marrin parasysh bioharmoninë dhe karakteristikat e tjera biologjike të burimeve, si dhe marrëdhëniet për shpërndarjen e burimeve të peshkimit dhe të veçorive gjeografike të rajonit përkatës, përfshirë gjendjen në të cilën ndodhen burimet, si dhe aktiviteti i peshkimit që ushtrohet mbi to në zonat brenda juridiksionit kombëtar;

e) marrin parasysh varësinë përkatëse të shteteve bregdetare dhe shteteve që ushtrojnë peshkim në dete të hapura nga burimet përkatëse; dhe

f) sigurojnë që këto masa të mos kenë ndikime të dëmshme mbi burimet e gjalla detare në tërësi.

3. Në zbatim të detyrimit të tyre për të bashkëpunuar, shtetet duhet të bëjnë çdo përpjekje për të rënë dakord mbi masat e marra për ruajtjen dhe menaxhimin brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

4. Nëse nuk mund të arrihet marrëveshje brenda një periudhe të arsyeshme kohore, çdo shtet i interesuar mund të kërkojë zbatimin e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në pjesën VIII.

5. Deri në arritjen e një marrëveshjeje mbi masat e marra për ruajtjen dhe menaxhimin, shtetet e interesuara, në frymën e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit, do të bëjnë çdo përpjekje për të hyrë në marrëveshje të përkohshme të një natyre praktike. Në rast se ato nuk arrijnë të bien dakord për një dakordësim të tillë, ndonjëri nga shtetet e interesuara mund ta paraqesë mosmarrëveshjen në një gjykatë ose arbitrazh për qëllime të marrjes së masave të përkohshme, në përputhje me procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në pjesën VIII.

6. Dakordësimet ose masat e përkohshme të marra ose të përcaktuara në përputhje me paragrafin 5 duhet të përfshijnë dispozitat e kësaj pjese, duhet të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e të gjitha shteteve të interesuara, nuk duhet të rrezikojnë ose pengojnë arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare mbi masat e zbatueshme për ruajtjen dhe menaxhimin, dhe nuk do të cenojnë rezultatin përfundimtar të çdo procedure për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

7. Shtetet bregdetare do të informojnë rregullisht shtetet që ushtrojnë peshkim në dete të hapura në nënrajon ose rajon, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet organizatave ose dakordësimeve të përshtatshme nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, ose nëpërmjet mjeteve të tjera të përshtatshme, mbi masat që ato kanë miratuar për burimet peshkore ndërkufitare dhe burimet shumëmigruese në zonat brenda juridiksionit të tyre kombëtar.

8. Shtetet që ushtrojnë peshkim në dete të hapura do t'i informojnë rregullisht shtetet e tjera të interesuara, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet organizatave ose marrëveshjeve të përshtatshme nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, ose nëpërmjet mjeteve të tjera të përshtatshme, mbi masat që ato kanë miratuar për organizimin e aktiviteteve të anijeve që mbajnë flamurin e tyre dhe që ushtrojnë peshkim në këto burime të deteve të hapura.

### PJESA III

## MEKANIZMAT PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR NË LIDHJE ME BURIMET PESHKORE NDËRKUFITARE DHE TË BURIMEVE SHUMËMIGRUESE

### Neni 8

#### **Bashkëpunimi për ruajtjen dhe menaxhimin**

1. Shtetet bregdetare dhe shtetet që ushtrojnë peshkim në dete të hapura, në përputhje me Konventën, do të vijojnë me bashkëpunimin, në lidhje me burimet peshkore ndërkufitare dhe burimet shumëmigruese, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatave ose dakordësimeve të përshtatshme nënrajonale ose rajonale për menaxhimin e peshkimit, duke marrë parasysh veçoritë specifike të nënrajonit ose rajonit, me qëllim sigurimin e ruajtjes dhe menaxhimin efektiv të këtyre burimeve.

2. Shtetet do të hyjnë në konsultime me mirëbesim dhe pa vonesë, veçanërisht kur ka prova që burimet peshkore ndërkufitare dhe burimet shumëmigruese përkatëse mund të jenë nën kërcënimin e mbishfrytëzimit ose kur një formë e re peshkimi është duke u zhvilluar për këto burime. Për këtë qëllim, konsultimet mund të nisen me kërkesë të çdo shteti të interesuar, me synim përcaktimin e dakordësimeve të përshtatshme për të siguruar ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve. Deri në arritjen e një dakordësimi të tillë, shtetet duhet të respektojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe duhet të veprojnë me mirëbesim dhe duke marrë në konsideratë të drejtat, interesat dhe detyrimet e shteteve të tjera.

3. Kur një organizatë ose dakordësim nënrajonale ose rajonale i menaxhimit të peshkimit ka kompetencën që të marrë masa për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare ose të burimeve shumëmigruese të caktuara, shtetet që ushtrojnë peshkim për këto burime në dete të hapura dhe shtetet bregdetare përkatëse do të përmbushin detyrimin e tyre për të bashkëpunuar, duke u bërë anëtarë të kësaj organizate ose pjesëmarrës në këtë marrëveshje, ose duke rënë dakord të zbatojnë masat për ruajtjen dhe menaxhimin e planifikuar nga kjo organizatë ose dakordësim. Shtetet që kanë një interes real në peshkimin përkatës mund të bëhen anëtarë të kësaj organizate ose

pjesëmarrës në këtë dakordësim. Kushtet e pjesëmarrjes në një organizatë ose dakordësim të tillë nuk duhet t'i përjashtojnë shtetet nga anëtarësimi ose pjesëmarrja; as nuk duhet të zbatohen në një mënyrë që diskriminon ndonjë shtet ose grup shtetesh që kanë një interes real në ato forma peshkimi përkatëse.

4. Vetëm ato shtete që janë anëtare të një organizate të tillë ose pjesëmarrëse në një dakordësim të tillë, ose që bien dakord të zbatojnë masat për ruajtjen dhe menaxhimin e planifikuar nga kjo organizatë ose dakordësim, do të kenë akses në burimet peshkore për të cilat këto masa zbatohen.

5. Kur nuk ka një organizatë ose dakordësim nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit për të marrë masa për ruajtjen dhe menaxhimin e një burimi të caktuar peshkor tranzit ose shumëmigruës, shtetet bregdetare përkatëse dhe shtetet që ushtrojnë peshkim në detin e hapur për këtë burim në nënrajon ose rajon do të bashkëpunojnë për të krijuar një organizatë të tillë, ose për të hyrë në dakordësime të tjera të përshtatshme për të siguruar ruajtjen dhe menaxhimin e këtij burimi dhe do të marrin pjesë në çështjen e organizatës ose dakordësimin.

6. Çdo shtet që synon të propozojë që një organizatë ndërqeveritare me kompetencë lidhur me burimet e gjalla të ndërmarrë veprime, kur një veprim i tillë do të kishte një ndikim të madh mbi masat për ruajtjen dhe menaxhimin, tashmë të marra nga një organizatë kompetente ose dakordësim nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, duhet, aty ku të jetë e mundur, të konsultohet nëpërmjet asaj organizate ose dakordësie me anëtarët ose pjesëmarrësit e saj. Këto konsultime, sa të jetë e zbatueshme, duhet të zhvillohen përpara paraqitjes së propozimit pranë organizatës ndërqeveritare.

#### Neni 9

### **Organizatave dhe dakordësimet nënrajonale dhe rajonale për menaxhimin e peshkimit**

1. Në krijimin e organizatave nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit ose në hyrjen në dakordësim nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit për burimet peshkore ndërkufitare dhe burimet shumëmigruese, shtetet bien dakord, ndër të tjera, mbi:

a) burimet për të cilat do të zbatohen masat për ruajtjen dhe menaxhimin, duke marrë në konsideratë karakteristikat biologjike të burimeve përkatëse dhe natyrën e formave të peshkimit të përfshira;

b) zonën e zbatimit, duke marrë në konsideratë nenin 7, paragrafi 1, dhe veçoritë e nënrajonit ose rajonit, përfshirë faktorët socio-ekonomikë, gjeografikë dhe mjedisorë;

c) marrëdhënien midis detyrave të organizatës ose dakordësisë së re dhe rolit, objektivave dhe veprimtarive të çdo organizate ose dakordësie ekzistuese përkatëse të menaxhimit të peshkimit; dhe

d) mekanizmat ndërmjet të cilëve organizata ose dakordësimi do të sigurojnë këshillim shkencor dhe do të rishikojë statusin e burimeve, përfshirë, aty ku të jetë e përshtatshme, krijimin e një organi këshillimor shkencor.

2. Shtetet që bashkëpunojnë për formimin e një organizate ose dakordësimi nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit duhet t'i informojnë shtetet e tjera, për të cilat janë në dijeni se kanë një interes real në çështjet e organizatës ose dakordësimin të propozuar, për këtë bashkëpunim.

#### Neni 10

### **Funksionet e organizatave dhe dakordësimeve nënrajonale dhe rajonale për menaxhimin e peshkimit**

Në përmbushje të detyrimit të tyre për të bashkëpunuar me organizatat apo dakordësimet nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, shtetet do të:

a) bien dakord dhe do të respektojnë masat për ruajtjen dhe menaxhimin për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese;

b) bien dakord, sipas rastit, mbi të drejtat pjesëmarrëse, siç janë ndarjet e kuotave të peshkimeve të lejuara ose nivelet e mundësive të peshkimit;

- c) miratojnë dhe zbatojnë çdo standard minimal ndërkombëtar të rekomanduar në përgjithësi për ushtrimin e përgjegjshëm të veprimtarive të peshkimit;
- d) sigurojnë dhe vlerësojnë këshillimin shkencor, rishikojnë statusin e burimeve dhe vlerësojnë ndikimin e peshkimit mbi speciet joobjekt peshkimi dhe mbi speciet e lidhura ose që varen prej tyre;
- e) bien dakord mbi standardet për grumbullimin, raportimin, verifikimin dhe shkëmbimin e të dhënave të varura nga peshkimi, për burimet;
- f) përpilojnë dhe shpërndajnë të dhëna statistikore të sakta dhe të plota, siç përshkruhet në shtojcën I, për të siguruar që evidencat më të mira shkencore të jenë të disponueshme, duke ruajtur konfidencialitetin aty ku është e përshtatshme;
- g) promovojnë dhe zhvillojnë vlerësime shkencore të burimeve dhe kërkime përkatëse, dhe t'i shpërndajnë rezultatet e tyre;
- h) krijojnë mekanizma bashkëpunues të përshtatshëm për monitorim, kontroll, mbikëqyrje dhe zbatim efektiv;
- i) bien dakord për mënyrat me të cilat do të akomodohen interesat e peshkimit të anëtarëve të rinj të organizatës ose pjesëmarrësve të rinj në dakordësim;
- j) bien dakord për procedurat e vendimmarrjes që lehtësojnë miratimin e masave për ruajtjen dhe menaxhimin në mënyrë të shpejtë dhe efektive;
- k) promovojnë zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve në përputhje me pjesën VIII;
- l) sigurojnë bashkëpunimin e plotë të agjencive kombëtare përkatëse dhe të industrisë, në zbatim të rekomandimeve dhe vendimeve të organizatës apo dakordësisë; dhe
- m) reklamojnë masat për ruajtjen dhe menaxhimin, të marra nga organizata ose dakordësimi.

#### Neni 11

### **Anëtarët ose pjesëmarrësit e rinj**

Në përcaktimin e natyrës dhe shkallës së të drejtave për anëtarët e rinj pjesëmarrës të një organizate nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, ose për pjesëmarrësit e rinj në një dakordësim nënrajonar, ose rajonal të menaxhimit të peshkimit, shtetet duhet të marrin parasysh, ndër të tjera:

- a) statusin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese, dhe nivelin ekzistues të sforcos të peshkimit për format përkatëse të peshkimit;
- b) interesat përkatës, metodat e peshkimit dhe praktikatat e peshkimit të anëtarëve ose pjesëmarrësve të rinj dhe ekzistues;
- c) kontributet përkatëse të anëtarëve ose pjesëmarrësve të rinj dhe ekzistues në ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve, në grumbullimin dhe sigurimin e të dhënave të sakta dhe në zhvillimin e kërkimit shkencor mbi burimet;
- d) nevojat e komuniteteve bregdetare të peshkimit që varen kryesisht nga peshkimi i këtyre burimeve;
- e) nevojat e shteteve bregdetare, ekonomitë e të cilave varen në masë dërrmuese nga shfrytëzimi i burimeve të gjalla detare; dhe
- f) interesat e shteteve në zhvillim nga nënrajoni ose rajoni, në zonat brenda juridiksionit të tyre kombëtar ku ndodhen, gjithashtu, këto burime.

#### Neni 12

### **Transparenca në veprimtaritë e organizatave dhe dakordësimeve nënrajonale dhe rajonale për menaxhimin e peshkimit**

1. Shtetet duhet të sigurojnë transparencë në procesin e vendimmarrjes dhe në veprimtaritë e tjera të organizatave dhe dakordësimeve nënrajonale dhe rajonale të menaxhimit të peshkimit.
2. Përfaqësues të organizatave të tjera ndërqeveritare dhe përfaqësues nga organizatat joqeveritare që merren me burimet peshkore ndërkufitare dhe burimet shumëmigruese do ta kenë mundësinë të marrin pjesë në mbledhjet e organizatave dhe dakordësimeve nënrajonale dhe rajonale të menaxhimit

të peshkimit, si vëzhgues ose në mënyra të tjera, sipas rastit, në përputhje me procedurat e organizatës ose dakordësisë përkatëse. Këto procedura nuk duhet të kufizohen pa arsye në këtë drejtim. Organizatat e tilla ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare do të kenë akses në kohë të përshtatshme në regjistrat dhe raportet e këtyre organizatave dhe dakordësimeve, duke iu nënshtruar rregullave procedurale për të aksesuar në to.

#### Neni 13

### **Forcimi i organizatave dhe dakordësimeve ekzistuese**

Shtetet duhet të bashkëpunojnë për të forcuar organizatat dhe dakordësimet ekzistuese nënrajonale dhe rajonale të menaxhimit të peshkimit, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të tyre në marrjen dhe zbatimin e masave për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese.

#### Neni 14

### **Mbledhja dhe sigurimi i informacionit dhe bashkëpunimi në kërkimin shkencor**

1. Shtetet duhet të sigurojnë që anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e tyre të ofrojnë informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, shtetet, në përputhje me shtojcën I:

a) do të mbledhin dhe shkëmbejnë të dhëna shkencore, teknike dhe statistikore, në lidhje me format e peshkimit për burimet peshkore ndërkufitare dhe për burimet shumëmigruese;

b) do të sigurojnë që të dhënat të mblidhen me hollësi të mjaftueshme për të lehtësuar vlerësimin efektiv të rezervave dhe të sigurohet dhënia e tyre në kohë për të përmbushur kërkesat e organizatave ose dakordësimeve nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit; dhe

c) do të marrin masa të përshtatshme për të verifikuar saktësinë e këtyre të dhënave.

2. Shtetet duhet të bashkëpunojnë, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatave ose dakordësimeve nënrajonale, ose rajonale të menaxhimit të peshkimit:

a) për të rënë dakord mbi specifikimet e të dhënave dhe formatin në të cilin ato do të sigurohen për organizatat ose dakordësime të tilla, duke marrë në konsideratë natyrën e burimeve dhe peshkimin për ato burime; dhe

b) për të zhvilluar dhe shkëmbyer teknika analitike dhe metodologji për vlerësimin e rezervave, me synim përmirësimin e masave për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese.

3. Në përputhje me pjesën XIII të Konventës, shtetet do të bashkëpunojnë, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente, për të forcuar kapacitetin e kërkimit shkencor në fushën e peshkimit dhe për të nxitur kërkimin shkencor që lidhet me ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese për përfitimin e të gjithëve. Për këtë qëllim, një shtet ose organizatë ndërkombëtare kompetente që kryen një kërkim të tillë përtej zonave të juridiksionit kombëtar do të promovojë në mënyrë aktive publikimin dhe shpërndarjen, tek çdo shtet i interesuar, të rezultateve të atij kërkimi dhe të informacionit që lidhet me objektivat dhe metodologjinë dhe, sa të jetë e mundur, do të lehtësojë pjesëmarrjen e shkencëtarëve nga këto shtete në kërkime të tilla.

#### Neni 15

### **Detet e mbyllura dhe gjysmë të mbyllura**

Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, në një det të mbyllur ose gjysmë të mbyllur, shtetet duhet të marrin në konsideratë veçoritë natyrore të atij deti dhe do të veprojnë, gjithashtu, në përputhje me pjesën IX të Konventës dhe me dispozitat e tjera përkatëse të saj.

#### Neni 16

## **Zonat në detet e hapura të rrethuara plotësisht nga një zonë brenda juridiksionit kombëtar të një shteti të vetëm**

1. Shtetet që ushtrojnë peshkim për burimet peshkore ndërkufitare dhe për burimet shumëmigruese në një zonë të detit të hapur të rrethuar plotësisht nga një zonë brenda juridiksionit kombëtar të një shteti të vetëm, ky i fundit, duhet të bashkëpunojë për të marrë masa për ruajtjen dhe menaxhimin e këtyre burimeve në atë zonë të detit të hapur. Duke marrë parasysh veçoritë natyrore të zonës, shtetet do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë marrjes së masave që zbatohen për ruajtjen dhe menaxhimin e këtyre burimeve, në përputhje me nenin 7. Masat e marra për detin e hapur do të përfshijnë të drejtat, detyrimet dhe interesat e shtetit bregdetar sipas Konventës, do të bazohen në evidencat më të mira shkencore të disponueshme dhe, gjithashtu, do të përfshijnë çdo masë për ruajtjen dhe menaxhimin e miratuar dhe të zbatuar për të njëjtat burime, në përputhje me nenin 61 të Konventës, nga shteti bregdetar në zonën brenda juridiksionit kombëtar. Shtetet do të bien, gjithashtu, dakord edhe për masat e monitorimit, kontrollit, mbikëqyrjes dhe të zbatimit për të siguruar respektimin e masave për ruajtjen dhe menaxhimin për detet e hapura.

2. Në zbatim të nenit 8, shtetet do të veprojnë me mirëbesim dhe do të bëjnë çdo përpjekje për të rënë dakord, pa vonesë, mbi masat për ruajtjen dhe menaxhimin që do të zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarive të peshkimit në zonën e përmendur në paragrafin 1. Nëse, brenda një periudhe kohore të arsyeshme, shtetet e interesuara që ushtrojnë aktivitetet peshkimi dhe shteti bregdetar nuk arrijnë të bien dakord mbi këto masa, ata, duke pasur parasysh paragrafin 1, do të zbatojnë nenin 7, paragrafët 4, 5 dhe 6, që lidhen me dakordësimet ose masat e përkohshme. Në pritje të përcaktimit të këtyre dakordësimeve ose masave të përkohshme, shtetet e interesuara duhet të marrin masa, në lidhje me anijet që mbajnë flamurin e tyre, në mënyrë që ato të mos angazhohen në aktivitete peshkimi që mund të cenojnë burimet përkatëse.

### PJESA IV SHTETET JOANËTARE DHE JOPJESËMARRËSE

#### Neni 17

#### **Shtetet joanëtare të organizatave dhe jopjesëmarrëse në dakordësime**

1. Një shtet që nuk është anëtar i një organizate nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, ose që nuk është pjesëmarrëse në një dakordësim nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, dhe që nuk pranon të zbatojë masat për ruajtjen dhe menaxhimin, të dala nga një organizatë ose dakordësim i tillë, nuk përjashtohet nga detyrimi për të bashkëpunuar, në përputhje me Konventën dhe këtë Marrëveshje, në ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve përkatëse peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese.

2. Një shtet i tillë nuk duhet të autorizojë anijet që mbajnë flamurin e tij që të angazhohen në veprimtari peshkimi për burimet peshkore ndërkufitare ose burimet shumëmigruese që janë subjekt i masave për ruajtjen dhe menaxhimin të dala nga një organizatë ose dakordësim i tillë.

3. Shtetet që janë anëtare të një organizate nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit ose pjesëmarrëse në një dakordësim nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit duhet të kërkojnë, veç e veç ose së bashku, nga subjektet e peshkimit të përmendura në nenin 1, paragrafi 3, të cilat kanë anije peshkimi që operojnë në zonën përkatëse, të bashkëpunojnë plotësisht me organizatën ose dakordësinë përkatëse, në zbatimin e masave për ruajtjen dhe menaxhimin që ajo ka vendosur, me qëllim që këto masa të zbatohen *de facto*, sa më gjerë të jetë e mundur, për veprimtaritë e peshkimit në zonën përkatëse. Subjekte të tilla të peshkimit do të gëzojnë përfitime nga pjesëmarrja në aktivitete peshkimi, në përpjesëtim me angazhimin e tyre për të respektuar masat për ruajtjen dhe menaxhimin në lidhje me burimet.

4. Shtetet që janë anëtare të një organizate të tillë ose pjesëmarrëse në një dakordësim të tillë do të shkëmbejnë informacion në lidhje me aktivitetet e anijeve të peshkimit që mbajnë flamurin e shteteve të cilat nuk janë as anëtare të organizatës dhe as pjesëmarrëse në dakordësim, dhe që janë të

angazhuara në veprimtari peshkimi për burimet përkatëse. Këto shtete do të marrin masa, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe të së drejtës ndërkombëtare, për të penguar aktivitetet e këtyre anijeve që cenojnë efektivitetin e masave nënrajonale ose rajonale për ruajtjen dhe menaxhimin.

## PJESA V DETYRIMET E SHTETIT TË FLAMURIT

### Neni 18

#### **Detyrimet e shtetit të flamurit**

1. Një shtet, anijet e të cilit ushtrojnë peshkim në dete të hapura, duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar që anijet që mbajnë flamurin e tij të respektojnë masat nënrajonale dhe rajonale për ruajtjen dhe menaxhimin, si dhe që këto anije të mos përfshihen në asnjë aktivitet që cenon efektivitetin e këtyre masave.

2. Një shtet duhet të autorizojë përdorimin e anijeve që mbajnë flamurin e tij për aktivitete peshkimi në det të hapur vetëm kur të jetë në gjendje të ushtrojë në mënyrë efektive përgjegjësitë e tij, në lidhje me këto anije sipas Konventës dhe kësaj Marrëveshjeje.

3. Masat që duhet të ndërmerren nga një shtet në lidhje me anijet që mbajnë flamurin e tij, përfshijnë:

a) kontrollin e këtyre anijeve në det të hapur me anë të licencave, autorizimeve ose lejeve të peshkimit, në përputhje me çdo procedurë të zbatueshme të rënë dakord në nivel nënrajonale, rajonale ose global;

b) vendosjen e rregulloreve:

i. për të aplikuar kushte dhe terma licencimi, autorizimi ose leje të nevojshme për të përmbushur çdo detyrim nënrajonale, rajonale, ose globale të shtetit të flamurit;

ii. për të ndaluar peshkimin në det të hapur nga anije që nuk janë të licencuara ose të autorizuar për të peshkuar në mënyrë të rregullt, ose peshkimin në det të hapur nga anije ndryshe nga sa parashikohet në kushtet e një licence, autorizimi ose leje;

iii. për të kërkuar që anijet që ushtrojnë peshkim në det të hapur të mbajnë gjithmonë në bord licencën, autorizimin ose lejen dhe ta paraqesin atë me kërkesë për inspektim nga një person i autorizuar zyrtarisht; dhe

iv. për të siguruar që anijet që mbajnë flamurin e tij të mos kryejnë peshkim të paautorizuar brenda zonave nën juridiksionin kombëtar të shteteve të tjera;

c) krijimin e një regjistri kombëtar të anijeve të peshkimit të autorizuar për të peshkuar në det të hapur dhe sigurimin e aksesit në informacionin e përfshirë në këtë regjistër me kërkesë nga shtetet drejtpërdrejtë të interesuara, duke marrë parasysh çdo ligj kombëtar të shtetit të flamurit mbi publikimin e këtij informacioni;

d) kërkesat për shënjimin e anijeve dhe veglave të peshkimit për identifikim, në përputhje me sistemet uniforme dhe të njohura ndërkombëtarisht për shënjimin e anijeve dhe veglave, siç janë Specifikimet Standarde të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara (FAO) për Shënjimin dhe Identifikimin e Anijeve të Peshkimit;

e) kërkesat për regjistrimin dhe raportimin në kohë të pozicionit të anijes, gjuetisë së specieve objekt dhe joobjekt peshkimi, sforcos së peshkimit dhe të të dhënave të tjera përkatëse të peshkimit, në përputhje me standardet nënrajonale, rajonale dhe globale për grumbullimin e këtyre të dhënave;

f) kërkesat për verifikimin e gjuetisë së specieve objekt dhe joobjekt peshkimi, nëpërmjet mjeteve të tilla si: programet e vëzhguesve, skemat e inspektimit, raportet e hedhurinave, mbikëqyrja e transbordimit dhe monitorimi i gjahut të zbarkuar dhe i statistikave të tregut;

g) monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e këtyre anijeve, veprimtarive të tyre të peshkimit dhe aktiviteteve të ngjashme të lidhura, ndër të tjera:

i. të zbatimit të skemave kombëtare të inspektimit dhe të skemave nënrajonale dhe rajonale për bashkëpunim në zbatim të masave, në përputhje me nenet 21 dhe 22, duke përfshirë kërkesat që këto anije të lejojnë aksesin nga inspektorë të autorizuar zyrtarisht nga shtete të tjera;

ii. të zbatimit të programeve kombëtare të vëzhgimit dhe të programeve nënrajonale, dhe rajonale të vëzhgimit, ku shteti i flamurit është pjesëmarrës, përfshirë kërkesat që këto anije të lejojnë aksesin nga vëzhgues të shteteve të tjera për të kryer funksionet e dakordësuara në kuadër të programeve; dhe

iii. të zhvillimit dhe zbatimit të sistemeve të monitorimit të anijeve, duke përfshirë, sipas rastit, sistemet satelitore të transmetimit, në përputhje me çdo program kombëtar dhe ato që janë dakordësuar në nivel nënrajonal, rajonal ose global midis shteteve të interesuara;

h) rregullimin e transbordimit në dete të hapura për të siguruar që efektiviteti i masave për ruajtjen dhe menaxhimin të mos cenohet; dhe

i) rregullimin e veprimtarive të peshkimit për të siguruar pajtueshmërinë me masat nënrajonale, rajonale ose globale, përfshirë ato që synojnë minimizimin e gjuetisë së specieve joobjekt peshkimi.

4. Kur është në fuqi një sistem i dakordësuar në nivel nënrajonal, rajonal ose global për monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen, shtetet duhet të sigurojnë që masat e marra për anijet që mbajnë flamurin e tyre të jenë në përputhje me atë sistem.

## PJESA VI PAJTUESHMËRIA DHE ZBATIMI

### Neni 19

#### **Pajtueshmëria dhe zbatimi nga shteti i flamurit**

1. Një shtet duhet të sigurojë pajtueshmërinë me anijet që mbajnë flamurin e tij me masat nënrajonale dhe rajonale për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare, dhe të burimeve shumëmigruese. Për këtë qëllim, ai shtet duhet të:

a) zbatojë këto masa, pavarësisht vendit ku ndodhin shkeljet;

b) hetojë menjëherë dhe plotësisht çdo shkelje të pretenduar të masave nënrajonale ose rajonale për ruajtjen dhe menaxhimin, gjë që mund të përfshijë inspektimin fizik të anijeve përkatëse, dhe të raportojë pa vonesë tek shteti që pretendon shkeljen dhe tek organizata ose dakordësimi nënrajonal, ose rajonal përkatës mbi ecurinë dhe rezultatin e hetimit;

c) kërkojë që çdo anije që mban flamurin e tij t'i japë informacion autoritetit hetues, lidhur me pozicionin e anijes, gjahun, veglat e peshkimit, veprimtaritë e peshkimit dhe aktivitetet e lidhura në zonën e një shkeljeje të pretenduar;

d) nëse është i bindur se ka prova të mjaftueshme në lidhje me një shkelje të pretenduar, t'ia referojë çështjen autoriteteve të tij me synim fillimin e procedurave pa vonesë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe, kur është e përshtatshme, të ndalojë anijen përkatëse; dhe

e) të sigurojë që, kur është provuar, në përputhje me legjislacionin kombëtar, se një anije ka qenë e përfshirë në kryerjen e një shkeljeje serioze të këtyre masave, ajo anije të mos angazhohet në veprimtari peshkimi në det të hapur deri në përmbushjen e të gjitha sanksioneve të pazgjdhura të vendosura nga shteti i flamurit për shkeljen.

2. Të gjitha hetimet dhe procedurat gjyqësore duhet të kryhen në mënyrë të përsheptuar. Sanksionet e zbatueshme në lidhje me shkeljet duhet të jenë në proporcion me shkeljet për të qenë efektive në sigurimin e pajtueshmërisë dhe për të dekurajuar shkeljet kudo që ato ndodhin dhe do t'i privojnë shkelësit nga përfitimet që rrjedhin nga veprimtaritë e tyre të paligjshme. Masat e zbatueshme në lidhje me kapitenët dhe anëtarët e tjerë të ekuipazhit të anijeve të peshkimit do të përfshijnë dispozita që mund të lejojnë, ndër të tjera, refuzimin, tërheqjen ose pezullimin e autorizimeve për të shërbyer si kapitenë ose anëtar ekuipazhi në këto anije.

### Neni 20

#### **Bashkëpunimi ndërkombëtar në zbatim**

1. Shtetet duhet të bashkëpunojnë, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatave ose dakordësimeve nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, për të siguruar pajtueshmërinë

dhe zbatimin e masave nënrajonale dhe rajonale për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese.

2. Një shtet i flamurit që kryen një hetim për një shkelje të pretenduar të masave për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare ose të burimeve shumëmigruese mund të kërkojë asistencën e çdo shteti tjetër, bashkëpunimi i të cilit mund të jetë i dobishëm në zhvillimin e atij hetimi. Të gjitha shtetet duhet të përpiqen të plotësojnë kërkesat e arsyeshme të bëra nga një shtet i flamurit për këto hetime.

3. Një shtet i flamurit mund të ndërmarrë hetime të tilla drejtpërdrejt, në bashkëpunim me shtete të tjera të interesuara ose nëpërmjet organizatës ose dakordësimit përkatës nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit. Informacioni mbi ecurinë dhe rezultatin e hetimeve do t'u sigurohet të gjitha shteteve që kanë një interes ose që preken nga shkelja e pretenduar.

4. Shtetet duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën në identifikimin e anijeve për të cilat është raportuar se janë përfshirë në aktivitete që cenojnë efektivitetin e masave nënrajonale, rajonale ose globale për ruajtjen dhe menaxhimin.

5. Shtetet, deri në masën që lejohet nga ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare, do të krijojnë dakordësi për vënien në dispozicion të autoriteteve ndjekëse penale në shtetet e tjera të provave që lidhen me shkeljet e pretenduara të këtyre masave.

6. Kur ka dyshime të arsyeshme për të besuar se një anije në det të hapur është përfshirë në peshkim të paautorizuar në një zonë brenda juridiksionit të një shteti bregdetar, shteti i flamurit i asaj anijeje, me kërkesë të shtetit bregdetar përkatës, do ta hetojë menjëherë dhe plotësisht çështjen. Shteti i flamurit do të bashkëpunojë me shtetin bregdetar në marrjen e masave të përshtatshme për zbatimin e ligjit në raste të tilla, dhe mund të autorizojë autoritetet përkatëse të shtetit bregdetar që të ngjiten dhe të inspektojnë anijen në det të hapur. Ky paragraf zbatohet pa prekur nenin 111 të Konventës.

7. Shtetet palë, që janë anëtare të një organizate nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, ose pjesëmarrëse në një dakordësim nënrajonale, ose rajonale të menaxhimit të peshkimit mund të ndërmarrin veprime në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë përdorimin e procedurave nënrajonale ose rajonale të krijuara për këtë qëllim, për të penguar anijet që janë përfshirë në aktivitete që cenojnë efektivitetin ose shkelin masat e vendosura për ruajtjen dhe menaxhimin nga ajo organizatë ose dakordësim, që të ushtrojnë peshkim në det të hapur në nënrajon ose rajon, deri në momentin kur të merren masat e duhura nga shteti i flamurit.

## Neni 21

### **Bashkëpunimi nënrajonale dhe rajonale në zbatim**

1. Në çdo zonë të detit të hapur të mbuluar nga një organizatë ose dakordësim nënrajonale ose rajonale i menaxhimit të peshkimit, një shtet palë që është anëtar i një organizate të tillë ose pjesëmarrës në një dakordësim të tillë mund të ngjitet dhe të inspektojë nëpërmjet inspektorëve të tij të autorizuar zyrtarisht, në përputhje me paragrafin 2, anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e një shteti tjetër palë të kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nëse ky i fundit është apo jo anëtar i organizatës ose pjesëmarrës në një dakordësim, me qëllim sigurimin e respektimit të masave për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese të përcaktuara nga ajo organizatë ose dakordësim.

2. Shtetet do të vendosin, nëpërmjet organizatave ose dakordësimeve nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, procedura për ngjitjen në bord dhe inspektimin në bazë të paragrafit 1, si dhe procedura për zbatimin e dispozitave të tjera të këtij neni. Këto procedura do të jenë në përputhje me këtë nen dhe me procedurat bazë të përcaktuara në nenin 22, dhe nuk do të diskriminojnë shtetet joanëtare të organizatës ose jopjesëmarrëse në dakordësim. Ngjitja në bord dhe inspektimi, si dhe çdo veprim i mëtejshëm i zbatimit do të kryhen në përputhje me këto procedura. Shtetet do t'i publikojnë në mënyrën e duhur procedurat e vendosura sipas këtij paragrafi.

3. Nëse, brenda dy vjetëve nga miratimi i kësaj Marrëveshjeje, ndonjë organizatë ose dakordësim nuk ka caktuar procedura të tilla, ngjitja në bord dhe inspektimi në bazë të paragrafit 1, si dhe çdo

veprim i mëtejshëm i zbatimit, do të kryhen, deri në përcaktimin e këtyre procedurave, në përputhje me këtë nen dhe me procedurat bazë të përcaktuara në nenin 22.

4. Përpara se të ndërmerren veprime sipas këtij neni, shtetet inspektuese do të informojnë mbi formën e identifikimit të lëshuar për inspektorët e tyre të autorizuar ligjërish, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatës, ose dakordësimit përkatës nënrajon, ose rajonal të menaxhimit të peshkimit, të gjitha shtetet, anijet e të cilëve ushtrojnë peshkim në det të hapur në nënrajon ose rajon. Anijet e përdorura për inspektim duhet të shënjojnë qartë dhe të jenë të dallueshme. Në momentin e aderimit në këtë Marrëveshje, një shtet do të caktojë një autoritet përkatës për të marrë njoftime sipas këtij neni dhe do ta bëjë të ditur këtë përzgjedhje nëpërmjet organizatës ose dakordësimit përkatës nënrajon, ose rajonal të menaxhimit të peshkimit.

5. Në rast se, pas ngjitjes në bord dhe inspektimit, ka baza të qarta për të besuar se një anije është angazhuar në ndonjë veprimtari në kundërshtim me masat për ruajtjen dhe menaxhimin e përmendur në paragrafin 1, shteti inspektues do të sigurojë, sipas rastit, provat dhe do ta njoftojë pa vonesë shtetin e flamurit për shkeljen e pretenduar.

6. Shteti i flamurit do t'i përgjigjet njoftimit të përmendur në paragrafin 5 brenda tre ditëve pune nga marrja e njoftimit ose brenda një periudhe tjetër të parashikuar në procedurat e përcaktuara në përputhje me paragrafin 2, dhe do të:

a) përmbushë, pa vonesë, detyrimet e tij sipas nenit 19 për të hetuar dhe, nëse provat e justifikojnë, të ndërmarrë masa ndëshkuese në lidhje me anijen, rast për të cilin menjëherë do ta informojë shtetin inspektues mbi rezultatet e hetimit dhe çdo veprim të ndërmarrë; ose

b) ta autorizojë shtetin inspektues për të hetuar.

7. Kur shteti i flamurit e autorizon shtetin inspektues të hetojë një shkelje të pretenduar, shteti inspektues do t'i komunikojë pa vonesë rezultatet e hetimit shtetit të flamurit. Shteti i flamurit, nëse provat vërtetohen, do të përmbushë detyrimet e tij për të ndërmarrë masa ndëshkuese në lidhje me anijen. Përndryshe, shteti i flamurit mund të autorizojë shtetin inspektues që të ndërmarrë masa ndëshkuese ashtu siç do t'i përcaktojë shteti i flamurit në lidhje me anijen, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e shtetit të flamurit sipas kësaj Marrëveshjeje.

8. Në rast se, pas ngjitjes në bord dhe inspektimit, ka baza të qarta për të besuar se një anije ka kryer një shkelje të rëndë, dhe shteti i flamurit ose nuk ka reaguuar, ose nuk ka ndërmarrë veprime siç kërkohen nga paragrafët 6 ose 7, inspektorët mund të qëndrojnë në bord dhe të sigurojnë provat, dhe mund t'i kërkojnë kapitenit të ndihmojë në hetime të mëtejshme, duke përfshirë, sipas rastit, kthimin e anijes pa vonesë në portin më të afërt të përshtatshëm, ose në një port tjetër të përcaktuar në procedurat e vendosura në përputhje me paragrafin 2. Shteti inspektues do ta informojë menjëherë shtetin e flamurit rreth portit ku anija do të dërgohet. Shteti inspektues dhe shteti i flamurit dhe, sipas rastit, shteti portual do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mirëqenien e ekuipazhit pavarësisht nga kombësia e tyre.

9. Shteti inspektues do ta informojë shtetin e flamurit dhe organizatën përkatëse ose pjesëmarrësit në dakordësimin përkatës mbi rezultatet e çdo hetimi të mëtejshëm.

10. Shteti inspektues do të kërkojë që inspektorët e tij të respektojnë rregullat, procedurat dhe praktikat e pranura ndërkombëtarisht që lidhen me sigurinë e anijes dhe të ekuipazhit, të minimizojnë ndërhyrjen në operacionet e peshkimit dhe, sa të jetë e mundur, të shmangin veprimet që do të ndikojnë negativisht në cilësinë e gjahut në bord. Shteti inspektues do të sigurojë që ngjitja në bord dhe inspektimi të mos kryhen në atë mënyrë që të përbëjë shqetësim për ndonjë anije peshkimi.

11. Për qëllimet e këtij neni, shkelje e rëndë do të thotë:

a) peshkim pa një licencë, autorizim ose leje të vlefshme të lëshuar nga shteti i flamurit, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 (a);

b) mosmbajtja e regjistrave të saktë të peshkimit dhe të të dhënave të lidhura me peshkimin, siç kërkohet nga organizata ose dakordësimi përkatës nënrajon ose rajonal i menaxhimit të peshkimit, ose raportimi i rremë i gjahut, në kundërshtim me kërkesat për raportimin e peshkimit të një organizate ose dakordësimi të tillë;

c) peshkimi në një zonë të ndaluar, peshkimi gjatë një sezoni ndalimi peshkimi pa pasur një kuotë ose pas ezaurimit të kuotës së vendosur nga organizata, ose dakordësimi përkatës nënrajonat, ose rajonal i menaxhimit të peshkimit;

d) peshkimi i drejtuar për në një resurs që është subjekt i një moratoriumi ose për të cilin peshkimi është i ndaluar;

e) përdorimi i veglave të ndaluara të peshkimit;

f) falsifikimi ose fshehja e shënjimeve, identitetit ose regjistrimit të një anijeje peshkimi;

g) fshehja, manipulimi ose asgjësimi i provave që lidhen me një hetim;

h) shkelje të shumta të cilat së bashku përbëjnë shkelje të rëndë të masave për ruajtjen dhe menaxhimin; ose

i) shkelje të tjera që mund të përcaktohen në procedurat e përcaktuara nga organizata ose dakordësimi përkatës nënrajonat ose rajonal i menaxhimit të peshkimit.

12. Pavarësisht dispozitave të tjera të këtij neni, shteti i flamurit mund të ndërmarrë, në çdo kohë, veprime për të përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 19 për një shkelje të pretenduar. Kur anija është nën drejtimin e shtetit inspektues, ky i fundit, me kërkesë të shtetit të flamurit, do ta lirojë anijen për hatë të shtetit të flamurit, së bashku me të gjithë informacionin mbi ecurinë dhe rezultatin e hetimit të tij.

13. Ky nen nuk cenon të drejtën e shtetit të flamurit për të ndërmarrë çdo masë, përfshirë procedurat për vendosjen e sanksioneve, sipas ligjeve të tij.

14. Ky nen zbatohet në mënyrë reciproke për ngjitjen në bord dhe inspektimin nga një shtet palë që është anëtar i një organizate nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, ose pjesëmarrës në një dakordësim nënrajonat, ose rajonal të menaxhimit të peshkimit dhe që ka prova për të besuar se një anije peshkimi që mban flamurin e një shteti tjetër palë është angazhuar në ndonjë veprimtari në kundërshtim me masat përkatëse për ruajtjen dhe menaxhimin të përmendura në paragrafin 1 në zonën e detit të hapur që mbulohet nga ajo organizatë ose dakordësim, dhe një anije e tillë është futur më pas, gjatë të njëjtit udhëtim peshkimi, në një zonë brenda juridiksionit kombëtar të shtetit inspektues.

15. Kur një organizatë ose dakordësim nënrajonat ose rajonal i menaxhimit të peshkimit ka vendosur një mekanizëm alternativ që përmbush në mënyrë efektive detyrimin sipas kësaj Marrëveshjeje të anëtarëve të saj ose pjesëmarrësve për të siguruar respektimin e masave për ruajtjen dhe menaxhimin e përcaktuar nga ajo organizatë, ose dakordësim, anëtarët e një organizate të tillë ose pjesëmarrësit në një dakordësim të tillë mund të bien dakord për të kufizuar zbatimin e paragrafit 1 ndërmjet tyre, në lidhje me masat e marra për ruajtjen dhe menaxhimin, të përcaktuara në zonën përkatëse në detet e hapura.

16. Veprimet e ndërmarra nga shtetet e tjera përveç shtetit të flamurit, në lidhje me anijet që janë angazhuar me aktivitetet në kundërshtim me masat nënrajonale ose rajonale për ruajtjen dhe menaxhimin do të jenë proporcionale me shkallën e shkeljes.

17. Kur ka baza të arsyeshme për të dyshuar se një anije peshkimi në det të hapur është pa kombësi, një shtet mund të ngjitet në bord dhe ta inspektojë anijen. Kur provat vërtetohen, shteti mund të ndërmarrë veprime të përshtatshme në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

18. Shteti është përgjegjës për çdo dëm apo humbje të shkaktuar si rezultat i veprimeve të ndërmarra në kuadër të zbatimit të këtij neni, kur këto veprime janë të paligjshme ose tejkalojnë kufijtë e duhur dhe proporcionale, në raport me informacionin e disponueshëm për zbatimin e dispozitave të këtij neni.

## Neni 22

### **Procedurat bazë për ngjitjen në bord dhe inspektimin në përputhje me nenin 21**

1. Shteti inspektues do të sigurojë që inspektorët e tij të autorizuar:

a) t'i ia paraqesin dokumentet e identifikimit kapitenit të anijes dhe t'i japin një kopje të tekstit të masave përkatëse të ruajtjes dhe menaxhimit ose të rregullave dhe rregulloreve në fuqi në zonën përkatëse të detit të hapur sipas atyre masave;

- b) t'ia përcjellin njoftimin shtetit të flamurit në momentin e ngjitjes në bord dhe inspektimit;
- c) të mos ndërhyjnë kur kapiteni dëshiron të komunikojë me autoritetet e shtetit të flamurit gjatë ngjitjes në bord dhe inspektimit;
- d) t'i japin kapitenit dhe autoriteteve të shtetit të licencuar një kopje të raportit mbi ngjitjen në bord dhe inspektimin, duke shënuar aty çdo kundërshtim ose deklaratë që kapiteni dëshiron të përfshijë në raport;
- e) të largohen menjëherë nga anija pas përfundimit të inspektimit nëse nuk gjejnë prova të një shkeljeje të rëndë; dhe
- f) të shmangin përdorimin e forcës përveçse rasteve kur është e nevojshme për sigurinë e inspektorëve dhe kur pengohen në kryerjen e detyrave të tyre. Shkalla e forcës së përdorur duhet të jetë në proporcion me rrethanat përkatëse.

2. Inspektorët e një shteti inspektues të autorizuar zyrtarisht do të kenë autoritetin ta inspektojnë anijen, licencën e saj, pajisjet, mjetet, regjistrat, ambientet, peshkun dhe produktet e peshkut, si dhe çdo dokument tjetër përkatës të nevojshëm për të verifikuar respektimin e masave përkatëse të ruajtjes dhe menaxhimit.

3. Shteti i flamurit do të sigurojë që kapitenët e anijeve të:

- a) pranojnë dhe lehtësojnë ngjitjen e menjëhershme dhe të sigurt në bord të inspektorëve;
- b) bashkëpunojnë dhe ndihmojnë në inspektimin e anijes që të bëhet në përputhje me këto procedura;
- c) të mos pengojnë, frikësojnë ose ndërhyjnë tek inspektorët në përmbushjen e detyrave të tyre;
- d) të lejojnë inspektorët të komunikojnë me autoritetet e shtetit të flamurit dhe të shtetit inspektues gjatë ngjitjes në bord dhe inspektimit;
- e) të ofrojnë kushte të arsyeshme, duke përfshirë, sipas rastit, ushqim dhe akomodim për inspektorët; dhe
- f) të lehtësojnë zbarkimin e sigurt të inspektorëve.

4. Në rast se kapiteni i një anijeje refuzon të pranojë ngjitjen në bord dhe inspektimin, në përputhje me këtë nen dhe me nenin 21, shteti i flamurit, përveç rrethanave kur, në përputhje me rregullat, procedurat dhe praktikatat e pranuar ndërkombëtarisht që lidhen me sigurinë në det, është e nevojshme të shtyhet ngjitja në bord dhe inspektimi, do të udhëzojë kapitenin e anijes që t'i nënshtrohet menjëherë ngjitjes në bord dhe inspektimit dhe, nëse kapiteni nuk i bindet një udhëzimi të tillë, do t'ia pezullojë autorizimin e anijes për të peshkuar dhe do të urdhërojë kthimin e saj të menjëhershëm në port. Shteti i flamurit do ta informojë shtetin inspektues mbi veprimet që ka ndërmarrë kur lindin rrethanat e theksuara në këtë paragraf.

## Neni 23

### **Masat e marra nga shteti portual**

1. Një shtet portual ka të drejtën dhe detyrimin të marrë masa, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, që të nxisë efektivitetin e masave nënrajonale, rajonale dhe globale për ruajtjen dhe menaxhimin. Kur merr masa të tilla, shteti portual nuk do të diskriminojë në formë ose në realitet anijet e ndonjë shteti.

2. Një shtet portual mund, ndër të tjera, të inspektojë dokumentet, veglat e peshkimit dhe gjahun në bord të anijeve të peshkimit, kur këto anije janë të ankoruara vullnetarisht në portet e këtij shteti ose në терминалет e tij detare.

3. Shtetet mund të miratojnë rregullore që u japin kompetencë autoriteteve përkatëse kombëtare që të ndalojnë zbarkimet dhe transbordimet kur është vërtetuar se peshkimet janë kryer në një mënyrë që cenon efektivitetin e masave nënrajonale, rajonale ose globale për ruajtjen dhe menaxhimin në det të hapur.

4. Ky nen nuk i privon shtetet të ushtrojnë sovranitetin e tyre mbi portet në territorin e tyre, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

## PJESA VII

## KËRKESAT E SHTETEVE NË ZHVILLIM

### Neni 24

#### **Njohja e kërkesave të veçanta të shteteve në zhvillim**

1. Shtetet do t'i japin njohje të plotë kërkesave të veçanta të shteteve në zhvillim për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese, si dhe zhvillimin e formave të peshkimit për këto burime. Për këtë qëllim, shtetet, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të tjera të specializuara, Mekanizmit Global të Mjedisit, Komisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe organizatave e organeve të tjera ndërkombëtare dhe rajonale përkatëse, do t'u ofrojnë asistencë shteteve në zhvillim.

2. Në zbatimin e detyrimit për të bashkëpunuar në marrjen e masave për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese, shtetet duhet të marrin në konsideratë kërkesat e veçanta të shteteve në zhvillim, në veçanti:

a) cenueshmërinë e shteteve në zhvillim që varen nga shfrytëzimi i burimeve të gjalla detare, përfshirë plotësimin e kërkesave ushqimore të popullsisë të tyre ose përkatëse;

b) nevojën për të shmangur ndikimet e dëmshme dhe për të siguruar akses në burimet peshkore për peshkatarët e vegjël artizanal dhe tradicionalë, gratë që punojnë në sektorin e peshkimit, si dhe popujt autoktonë në shtetet në zhvillim, veçanërisht shtetet e vogla ishullore në zhvillim; dhe

c) nevojën për të siguruar që masa të tilla të mos çojnë në transferim të, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të një barre veprimi të tepruar për ruajtjen e shteteve në zhvillim.

### Neni 25

#### **Format e bashkëpunimit me shtetet në zhvillim**

1. Shtetet do të bashkëpunojnë, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatave nënrajonale, rajonale ose globale:

a) që të rrisin kapacitetet e shteteve në zhvillim, në veçanti të atyre më pak të zhvilluara dhe të shteteve të vegjël ishullore në zhvillim, që të ruajnë dhe menaxhojnë burimet peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese, si dhe të zhvillojnë peshkimin e tyre nëpër këto burime;

b) që të ndihmojnë shtetet në zhvillim, në veçanti ato më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim, që t'u mundësohet pjesëmarrja në aktivitete peshkimi në det të hapur për këto burime, përfshirë lehtësimin e aksesit në këto forma peshkimi, në përputhje me nenet 5 dhe 11; dhe

c) që të lehtësojnë pjesëmarrjen e shteteve në zhvillim në organizatat dhe dakordësimet nënrajonale dhe rajonale të menaxhimit të peshkimit.

2. Bashkëpunimi me shtetet në zhvillim, për qëllimet e përcaktuara në këtë nen, do të përfshijë dhënie e ndihmës financiare, ndihmës për zhvillimin e burimeve njerëzore, ndihmës teknike, transferimin e teknologjisë, si edhe nëpërmjet dakordësimeve të ndërmarrjeve të përbashkëta, si dhe shërbimeve këshillimore dhe konsultative.

3. Një ndihmë e tillë do t'i drejtohet, ndër të tjera, posaçërisht:

a) përmirësimit të ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese nëpërmjet grumbullimit, raportimit, verifikimit, shkëmbimit dhe analizimit të të dhënave të peshkimit dhe informacionit të lidhur me to;

b) vlerësimit të rezervave dhe kërkimit shkencor; dhe

c) monitorimit, kontrollit, mbikëqyrjes, respektimit dhe zbatimit, përfshirë trajnimin dhe forcimin e kapaciteteve në nivel lokal, zhvillimin dhe financimin e programeve kombëtare dhe rajonale të vëzhguesve, si dhe aksesin në teknologji dhe pajisje.

### Neni 26

#### **Asistenca e veçantë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje**

1. Shtetet do të bashkëpunojnë për të krijuar fonde të veçanta për të ndihmuar shtetet në zhvillim në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë ndihmën për shtetet në zhvillim për të përballuar kostot e përfshira në çdo procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ku ato mund të jenë palë.

2. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare duhet t'i ndihmojnë shtetet në zhvillim në krijimin e organizatave ose dakordësimeve të reja nënrajonale, ose rajonale të menaxhimit të peshkimit, ose në forcimin e organizatave, ose dakordësimeve ekzistuese, për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese.

## PJESA VIII ZGJIDHJA PAQËSORE E MOSMARRËVESHJEVE

### Neni 27

#### **Detyrimi për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve**

Shtetet kanë detyrimin t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre nëpërmjet negociatave, hetimeve, ndërmjetësimit, pajtimit, arbitrazhit, gjykimit, përdorimit të agjencive ose dakordësimeve rajonale, ose mjeteve të tjera paqësore sipas zgjedhjes së tyre.

### Neni 28

#### **Parandalimi i mosmarrëveshjeve**

Shtetet duhet të bashkëpunojnë për të parandaluar mosmarrëveshjet. Për këtë qëllim, shtetet duhet të bien dakord mbi procedura vendimmarrjeje efikase dhe të përshpejtuara brenda organizatave dhe dakordësimeve nënrajonale, dhe rajonale të menaxhimit të peshkimit, dhe të forcojnë procedurat ekzistuese të vendimmarrjes sipas nevojës.

### Neni 29

#### **Mosmarrëveshjet me natyrë teknike**

Kur një mosmarrëveshje ka të bëjë me një çështje me natyrë teknike, shtetet e interesuara mund t'ia referojnë mosmarrëveshjen një paneli *ad hoc* ekspertësh të ngritur prej tyre. Paneli duhet të konsultohet me shtetet e interesuara dhe duhet të përpiqet ta zgjidhë mosmarrëveshjen në mënyrë të përshpejtuar, pa iu drejtuar procedurave detyruese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

### Neni 30

#### **Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve**

1. Dispozitat që lidhen me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të parashikuara në pjesën XV, të Konventës, zbatohen në mënyrë reciproke për çdo mosmarrëveshje midis shteteve palë në këtë Marrëveshje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nëse ato janë ose jo, gjithashtu, palë në Konventë.

2. Dispozitat që lidhen me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të përcaktuara në pjesën XV, të Konventës, zbatohen në mënyrë reciproke për çdo mosmarrëveshje midis shteteve palë në këtë Marrëveshje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e një marrëveshjeje peshkimi nënrajonale, rajonale ose globale që lidhet me burimet peshkore ndërkufitare ose me burimet shumëmigruese, ku ato janë palë, përfshirë çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me ruajtjen dhe menaxhimin e këtyre burimeve, pavarësisht nëse ato janë ose jo, gjithashtu, palë në Konventë.

3. Çdo procedurë e pranuar nga një shtet palë në këtë Marrëveshje dhe në Konventë, në përputhje me nenin 287 të Konventës, do të zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas kësaj pjese, përveç rasteve kur shteti palë, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë

Marrëveshje, ose në çdo moment pas saj, ka pranuar një procedurë tjetër, në përputhje me nenin 287 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas kësaj pjese.

4. Një shtet palë në këtë Marrëveshje që nuk është palë në Konventë, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Marrëveshje, ose në çdo moment pas saj, është i lirë të zgjedhë, me anë të një deklaratë me shkrim, një ose më shumë nga mjetet e parashikuara në paragrafin 1, të nenit 287, të Konventës, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas kësaj pjese. Neni 287 zbatohet për një deklaratë të tillë, si dhe për çdo mosmarrëveshje ku ky shtet është palë dhe që nuk mbulohet nga një deklaratë në fuqi. Për qëllimet e pajtimit dhe arbitrazhit, në përputhje me shtojcat V, VII dhe VIII të Konventës, një shtet i tillë ka të drejtë të emërojë ndërmjetësues, arbitra dhe ekspertë për t'u përfshirë në listat e parashikuara në nenin 2, të shtojcës V, nenin 2, të shtojcës VII dhe nenin 2, të shtojcës VIII, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas kësaj pjese.

5. Çdo gjykatë apo gjykatë arbitrazhi që i është paraqitur një mosmarrëveshje sipas kësaj pjese do të zbatojë dispozitat përkatëse të Konventës, të kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo marrëveshjeje peshkimi nënrajonale, rajonale ose globale përkatëse, si dhe standardet përgjithësisht të pranura për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve të gjalla detare dhe rregullat e tjera të së drejtës ndërkombëtare që nuk janë në kundërshtim me Konventën, me synimin për të siguruar ruajtjen e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese përkatëse.

#### Neni 31

### **Masat e përkohshme**

1. Në pritje të zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje në përputhje me këtë pjesë, palët në mosmarrëveshje duhet të bëjnë çdo përpjekje për të hyrë në dakordësime të përkohshme me natyrë praktike.

2. Pa cenuar nenin 290 të Konventës, gjykata ose gjykata e arbitrazhit, ku është paraqitur mosmarrëveshja në përputhje me këtë pjesë mund të përcaktojë çdo masë të përkohshme që e konsideron të përshtatshme në rrethana të caktuara për të mbrojtur të drejtat përkatëse të palëve në mosmarrëveshje ose për të parandaluar dëmtimin e burimeve përkatëse, si edhe në rrethanat e parashikuara në paragrafin 5, të nenit 7 dhe në paragrafin 2, të nenit 16.

3. Një shtet palë në këtë Marrëveshje që nuk është palë në Konventë mund të deklarojë se, pavarësisht nga paragrafi 5, i nenit 290 të Konventës, Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit nuk ka të drejtë të përcaktojë, modifikojë ose heqë masa të përkohshme pa pëlqimin e atij shteti.

#### Neni 32

### **Kufizimet në zbatueshmërinë e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve**

Neni 297, paragrafi 3, i Konventës zbatohet, gjithashtu, edhe për këtë Marrëveshje.

#### PJESA IX

### **SHTETET JOPALË NË KËTË MARRËVESHJE**

#### Neni 33

### **Shtetet jopalë në këtë Marrëveshje**

1. Shtetet palë duhet të inkurajojnë shtetet jopalë në këtë Marrëveshje që të bëhen palë në të dhe të miratojnë ligje dhe rregullore në përputhje me dispozitat e saj.

2. Shtetet palë duhet të marrin masa në përputhje me këtë Marrëveshje dhe të drejtën ndërkombëtare për të penguar aktivitetet e anijeve që mbajnë flamurin e shteteve jopalë, të cilat cenojnë zbatimin efektiv të kësaj Marrëveshjeje.

#### PJESA X

### **MIRËBESIMI DHE SHPËRDORIMI I TË DREJTAVE**

Neni 34

### **Mirëbesimi dhe shpërdorimi i të drejtave**

Shtetet palë duhet të përmbushin me mirëbesim detyrimet e marra përsipër sipas kësaj Marrëveshjeje dhe duhet të ushtrojnë të drejtat e njohura në këtë Marrëveshje në një mënyrë që nuk do të përbënte shpërdorim të së drejtës.

### **PJESA XI**

#### **PËRGJEGJËSIA DHE DETYRIMET**

Neni 35

### **Përgjegjësia dhe detyrimet**

Shtetet palë mbajnë përgjegjësi, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për çdo dëm ose humbje që u atribuohet atyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

### **PJESA XII**

#### **KONFERENCA E RISHIKIMIT**

Neni 36

### **Konferenca e rishikimit**

1. Katër vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të thërrasë një konferencë, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të kësaj Marrëveshjeje në sigurimin e ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruës. Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në konferencë të gjitha shtetet palë dhe ato shtete e subjekte që kanë të drejtë të bëhen palë në këtë Marrëveshje, si edhe ato organizata ndërqeveritare dhe joqeveritare që kanë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues.

2. Konferenca do të rishikojë dhe vlerësojë përshtatshmërinë e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe, nëse është e nevojshme, do të propozojë mjete për forcimin e përmbajtjes dhe metodave të zbatimit të atyre dispozitave, me qëllim adresim më të mirë të problemeve të vazhdueshme në ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruës.

### **PJESA XIII**

#### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 37

### **Nënshkrimi**

Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet dhe subjektet e tjera të përmendura në nenin 1, paragrafi 2(b), dhe do të mbetet e hapur për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara për një periudhë dymbëdhjetë mujore që nga data katër e dhjetorit të 1995.

Neni 38

### **Ratifikimi**

Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit nga shtetet dhe subjektet e tjera të përmendura në nenin 1, paragrafi 2(b). Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 39  
**Aderimi**

Kjo Marrëveshje do të mbetet e hapur për aderim nga shtetet dhe subjektet e tjera të përmendura në nenin 1, paragrafi 2 (b). Instrumentet e aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 40  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të tridhjetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet ose subjekt që ratifikon Marrëveshjen ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të tridhjetë të ratifikimit ose aderimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 41  
**Zbatimi i përkohshëm**

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht nga një shtet ose subjekt që jep pëlqimin për zbatimin e saj të përkohshëm duke e njoftuar depozitarin me shkrim. Ky zbatim i përkohshëm do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit.

2. Zbatimi i përkohshëm nga një shtet ose subjekt do të përfundojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje për atë shtet ose subjekt, ose me njoftimin me shkrim nga ai shtet ose subjekt drejtuar depozitarit për qëllimin e tij për të ndërprerë zbatimin e përkohshëm.

Neni 42  
**Rezervat dhe përjashtimet**

Nuk mund të bëhen rezerva ose përjashtime ndaj kësaj Marrëveshjeje.

Neni 43  
**Deklaratat dhe qëndrimet**

Neni 42 nuk e pengon një shtet ose subjekt, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Marrëveshje, që të bëjë deklarata ose shpreh qëndrime, pavarësisht nga formulimi ose emërtimi i tyre, me qëllim, ndër të tjera, harmonizimin e ligjeve dhe rregulloreve të tij me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që këto deklarata ose qëndrime të mos synojnë përjashtimin, ose modifikimin e forcës juridike të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje në zbatimin e tyre për atë shtet ose subjekt.

Neni 44  
**Marrëdhënia me marrëveshjet e tjera**

1. Kjo Marrëveshje nuk do ndryshojë të drejtat dhe detyrimet e shteteve palë që rrjedhin nga marrëveshje të tjera në përputhje me këtë Marrëveshje dhe që nuk ndikojnë në ushtrimin nga shtetet e tjera palë të të drejtave të tyre ose në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Dy ose më shumë shtete palë mund të lidhin marrëveshje që të ndryshojnë ose pezullojnë zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, të cilat zbatohen vetëm për marrëdhëniet mes tyre, me kusht që këto marrëveshje të mos lidhen me ndonjë dispozitë, devijimi i së cilës është i papajtueshëm me zbatimin efektiv të objektit dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe me kusht që këto marrëveshje të mos cenojnë zbatimin e parimeve themelore të përfshira në të, si dhe që dispozitat e këtyre

marrëveshjeve të mos ndikojnë në ushtrimin nga shtetet e tjera palë të të drejtave të tyre ose në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Shtetet palë që synojnë të lidhin një marrëveshje të përmendur në paragrafin 2 do të njoftojnë shtetet e tjera palë, nëpërmjet depozitarit të kësaj Marrëveshjeje, nën objektin e tyre për të lidhur marrëveshjen dhe për ndryshimin ose pezullimin që ajo parashikon.

#### Neni 45 **Ndryshimi**

1. Një shtet palë mund të propozojë, në një komunikim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, ndryshime për këtë Marrëveshje dhe të kërkojë thirrjen e një konference për t'i shqyrtuar këto ndryshime të propozuara. Sekretari i Përgjithshëm do ta shpërndajë këtë komunikim tek të gjitha shtetet palë. Nëse, brenda gjashtë muajve nga data e shpërndarjes së komunikimit, jo më pak se gjysma e shteteve palë i përgjigjen pozitivisht kërkesës, Sekretari i Përgjithshëm do të thërrasë konferencën.

2. Procedura e zbatueshme e vendimmarrjes në konferencën e ndryshimeve, thirrur sipas paragrafit 1, do të jetë e njëjtë me atë që zbatohet në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Burimet Peshkore Ndërkufitare dhe Burimet Shumëmigruese, përveç rasteve kur konferenca vendos ndryshe. Konferenca duhet të bëjë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje për çdo ndryshim nëpërmjet konsensusit, dhe nuk duhet të ketë votim mbi to derisa të jenë shteruar të gjitha përpjekjet për arritjen e konsensusit.

3. Pasi të miratohen, ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje do të jenë të hapura për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara nga shtetet palë për një periudhë dymbëdhjetë mujore nga data e miratimit, përveç rasteve kur vetë ndryshimi parashikon ndryshe.

4. Nenet 38, 39, 47 dhe 50 zbatohen për të gjitha ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje.

5. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi për shtetet palë që i ratifikojnë ose aderojnë ato ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose aderimit nga dy të tretat e shteteve palë. Më pas, për çdo shtet palë që ratifikon ose aderon në një ndryshim pas depozitimit të numrit të kërkuar të instrumenteve të tilla, ndryshimi do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

6. Një ndryshim mund të parashikojë që një numër më i vogël ose më i madh ratifikimesh ose aderimesh të kërkojë për hyrjen e tij në fuqi më tepër sesa ai që kërkohet nga ky nen.

7. Një shtet që bëhet palë në këtë Marrëveshje pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në përputhje me paragrafin 5, në mungesë të shprehjes së një qëllimi të ndryshëm nga ai shtet:

a) do të konsiderohet si palë në këtë Marrëveshje, ashtu siç është ndryshuar; dhe

b) do të konsiderohet si palë në Marrëveshjen e pandryshuar në marrëdhënie me çdo shtet palë që nuk është i detyruar nga ndryshimi.

#### Neni 46 **Denoncimi**

1. Një shtet palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe mund të japë arsyet e tij. Mosparashtrimi i arsyeve nuk ndikon në vlefshmërinë e denoncimit. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit, përveç rasteve kur njoftimi përcakton një datë më të vonë.

2. Denoncimi nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë në detyrimin e ndonjë shteti palë për të përmbushur çdo detyrim të përfshirë në këtë Marrëveshje, të cilit ai do t'i nënshtrohej sipas së drejtës ndërkombëtare, pavarësisht nga kjo Marrëveshje.

#### Neni 47 **Pjesëmarrja e organizatave ndërkombëtare**

1. Në rastet kur një organizatë ndërkombëtare, e përmendur në aneksin IX, neni 1, të Konventës, nuk ka kompetencë mbi të gjitha çështjet e rregulluara nga kjo Marrëveshje, aneksi IX i Konventës do të zbatohet në mënyrë reciproke për pjesëmarrjen e një organizate të tillë ndërkombëtare në këtë Marrëveshje, me përjashtim të dispozitave vijuese të atij aneksi, të cilat nuk do të zbatohen:

- a) neni 2, fjalia e parë; dhe
- b) neni 3, paragrafi 1.

2. Në rastet kur organizata ndërkombëtare, e përmendur në aneksin IX, neni 1, të Konventës, ka kompetencë mbi të gjitha çështjet e rregulluara nga kjo Marrëveshje, atëherë do të zbatohen dispozitat e mëposhtme për pjesëmarrjen e një organizate të tillë ndërkombëtare në këtë Marrëveshje:

a) në momentin e nënshkrimit ose aderimit, organizata ndërkombëtare do të paraqesë një deklaratë, duke pohuar:

- i. se ka kompetencë mbi të gjitha çështjet e rregulluara nga kjo Marrëveshje;
- ii. se, për këtë arsye, shtetet anëtare të saj nuk do të bëhen shtete palë, përveç se për territore për të cilat organizata ndërkombëtare nuk ka përgjegjësi; dhe
- iii. se pranon të drejtat dhe detyrimet e shteteve sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) pjesëmarrja e një organizate të tillë ndërkombëtare në asnjë rast nuk do t'u japë shteteve anëtare të organizatës ndërkombëtare të drejta sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) në rast mosmarrëveshjeje për detyrimet e ndonjëris prej organizatave ndërkombëtare sipas kësaj Marrëveshjeje dhe detyrimeve të saj sipas marrëveshjes që krijon organizatën ndërkombëtare apo të çdo akti që lidhet me të, do të mbizotërojnë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 48 **Shtojcat**

1. Shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, një referencë ndaj kësaj Marrëveshjeje apo ndaj njëris prej pjesëve të saj do të përfshijë një referencë të shtojcave përkatëse.

2. Shtojcat mund të rishikohen herë pas here nga shtetet palë. Këto rishikime do të bazohen mbi konsiderata shkencore dhe teknike. Pavarësisht dispozitave të nenit 45, nëse rishikimi i një shtojce miratohet me konsensus në një mbledhje të shteteve palë, ajo do të përfshihet në këtë Marrëveshje dhe do të hyjë në fuqi që nga data e miratimit të saj ose nga një datë tjetër e përcaktuar në vetërishikim. Nëse rishikimi i një shtojce nuk miratohet me konsensus në një mbledhje të tillë, atëherë do të zbatohen procedurat e ndryshimit të përcaktuara në nenin 45.

#### Neni 49 **Depozitari**

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozitari i kësaj Marrëveshjeje dhe i çdo ndryshimi ose rishikimi të saj.

#### Neni 50 **Tekste autentike**

Tekstet në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle të kësaj Marrëveshjeje janë njësoj autentike.

NË DËSHMI TË KËSAJ, nënshkruesit e mëposhtëm fuqiplotë, të autorizuar në mënyrë të rregullt, për këtë qëllim, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

E HAPUR PËR NËNSHKRIM në Nju Jork, më datë katër dhjetor, një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë, në origjinal, në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle.

#### SHTOJCA I

# KËRKESAT STANDARDE PËR GRUMBULLIMIN DHE SHPËRNDARJEN E TË DHËNAVE

## Neni 1

### Parimet e përgjithshme

1. Grumbullimi, përpilimi dhe analiza në kohë e të dhënave janë themelore për ruajtjen dhe menaxhimin efektiv të burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese. Për këtë qëllim, të dhënat nga aktivitetet e peshkimit për këto burime në det të hapur dhe ato në zonat brenda juridiksionit kombëtar janë të domosdoshme dhe duhet të grumbullohen e përpilohen në atë mënyrë që të mundësojë analiza statistikore për qëllime të ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve peshkore. Këto të dhëna përfshijnë statistikën e peshkimit dhe të sforcos së peshkimit, si edhe informacione të tjera të lidhura me peshkimin, si të dhënat mbi anijet dhe të dhëna të tjera për standardizimin e sforcos së peshkimit. Të dhënat e grumbulluara duhet të përfshijnë, gjithashtu, informacion mbi speciet joobjekt peshkimi dhe ato të lidhura ose të varura. Të gjitha të dhënat duhet të verifikohen për të siguruar saktësinë e tyre. Konfidencialiteti i të dhënave të papërpunuara do të ruhet. Shpërndarja e këtyre të dhënave do t'i nënshtrohet kushteve sipas të cilave ato janë vënë në dispozicion.

2. Ndihma, duke përfshirë trajnimin, si edhe ndihmën financiare dhe teknike, do t'u ofrohet shteteve në zhvillim me qëllim që të ngrenë kapacitet në fushën e ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve të gjalla detare. Ndihma duhet të fokusohet në forcimin e kapacitetit për zbatimin e grumbullimit dhe verifikimit të të dhënave, programeve të vëzhgimit, analizës së të dhënave dhe projekteve kërkimore që mbështesin vlerësimin e burimeve. Duhet të promovohet përfshirja sa më e plotë e shkencëtarëve dhe menaxherëve nga shtetet në zhvillim, në ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve shumëmigruese.

## Neni 2

### Parimet e grumbullimit, përpilimit dhe shkëmbimit të të dhënave

Parimet e përgjithshme të mëposhtme duhet të merren në konsideratë gjatë përcaktimit të parametrave për grumbullimin, përpilimin dhe shkëmbimin e të dhënave nga veprimtaritë e peshkimit për burimet peshkore ndërkufitare dhe burimet shumëmigruese:

a) Shtetet duhet të sigurojnë që të dhënat të grumbullohen nga anijet që mbajnë flamurin e tyre mbi aktivitetet e peshkimit, sipas karakteristikave operacionale të secilës forme peshkimi (p.sh.: çdo operacion i veçantë peshkimi, me setin e tij të rrjetave rrethore apo jorrethore për çdo kohëzgjatje, gjuetinë e tufës së peshqve me grep me filispanjë apo kallam dhe operacionet e peshkimit me grep të fiksuar në anësore dhe me të dhënat e duhura për të mundësuar vlerësimin efektiv të burimeve);

b) Shtetet duhet të sigurojnë që të dhënat e peshkimit të verifikohen nëpërmjet një sistemi të përshtatshëm;

c) Shtetet duhet të përpilojnë të dhënat e lidhura me peshkimin dhe të dhënat shkencore mbështetëse dhe t'ia paraqesin ato në një format të dakordësuar dhe në kohën e duhur organizatës ose dakordësimin nënrajonal ose rajonal të menaxhimit të peshkimit, kur një e tillë ekziston. Përndryshe, shtetet duhet të bashkëpunojnë për shkëmbimin e të dhënave ose drejtpërdrejt, ose nëpërmjet mekanizmave të tjerë bashkëpunues rënë dakord mes tyre;

d) Shtetet duhet të bien dakord, brenda kuadrit të organizatave ose dakordësimeve të menaxhimit të peshkimit nënrajonal ose rajonal apo mbi specifikimin e të dhënave dhe formatin në të cilin ato do të paraqiten, në përputhje me këtë shtojcë dhe duke marrë parasysh natyrën e burimeve, dhe peshkimit për ato burime në rajon. Organizata apo marrëveshje të tilla duhet t'u kërkojnë shteteve joanëtare ose jopjesëmarrëse të paraqesin të dhëna në lidhje me veprimtaritë përkatëse të peshkimit nga anijet që mbajnë flamurin e tyre;

e) organizata ose dakordësimet të tilla do t'i përpilojnë të dhënat dhe do t'i vënë ato në dispozicion, në kohën e duhur dhe në një format të dakordësuar, për të gjitha shtetet e interesuara, sipas kushteve të përcaktuara nga organizata ose dakordësimet; dhe

f) ekspertët shkencor të shtetit të flamurit dhe ata nga organizata ose dakordësimi përkatës i menaxhimit të peshkimit nënrajonat ose rajonal duhet t'i analizojnë të dhënat, qoftë veçmas ose së bashku, sipas rastit.

### Neni 3

#### **Të dhënat bazë të peshkimit**

1. Shtetet do t'i grumbullojnë dhe do t'i vënë në dispozicion të organizatës ose dakordësimi përkatës të menaxhimit të peshkimit, në nivel nënrajonat ose rajonal, llojet e mëposhtme të të dhënave, me detajet e duhura për të mundësuar vlerësimin efektiv të burimeve, në përputhje me procedurat e dakorduara:

- a) periudhat kohore të statistikave të peshkimit dhe sforcos sipas formave të peshkimit dhe flotës;
- b) peshkimin total në numër, peshën nominale ose të dyja, sipas specieve (si për speciet objekt, dhe joobjekti peshkimi), sipas rastit për secilën formë peshkimi. [Pesha nominale përcaktohet nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara si ekuivalenti i peshës së gjallë të zbarkimeve];
- c) statistika për hedhurinat, duke përfshirë vlerësimet kur të jetë e nevojshme, të raportuara si numër ose peshë nominale sipas specieve, sipas rastit për secilën formë peshkimi;
- d) statistika mbi sforcon e peshkimit, të përshtatshme për secilën formë peshkimi; dhe
- e) vendndodhjen e aktiviteteve të peshkimit, datën dhe kohën e peshkimit, dhe statistikat e tjera mbi operacionet e peshkimit sipas rastit.

2. Shtetet do të mbledhin, gjithashtu, sipas rastit, dhe do t'ia paraqesin organizatës ose dakordësimi përkatës të menaxhimit të peshkimit nënrajonat ose rajonal, informacionin mbështetës për vlerësimin e burimeve, duke përfshirë:

- a) përbërjen e gjahut sipas gjatësisë, peshës dhe seksit;
- b) informacione të tjera biologjike që mbështesin vlerësimin e burimeve, si të dhënat mbi moshën, rritjen, rekrutimin, shpërndarjen dhe identitetin e burimeve; dhe
- c) kërkime të tjera përkatëse, duke përfshirë anketat mbi sasinë, anketat mbi biomasa, studimet hidro-akustike, kërkimet mbi faktorët mjedisorë që ndikojnë në sasinë e burimeve, si edhe studimet oqeanografike dhe ekologjike.

### Neni 4

#### **Të dhënat dhe informacioni mbi anijet**

1. Shtetet duhet të mbledhin llojet e mëposhtme të të dhënave të lidhura me anijet për standardizimin e përbërjes së flotës dhe fuqisë së peshkimit të anijeve, si dhe për konvertimin midis masave të ndryshme të sforcos gjatë analizës së të dhënave të gjahut dhe sforcos:

- a) identifikimi i anijes, flamurit dhe portit të regjistrimit;
- b) tipi i anijes;
- c) specifikimet e anijes (p.sh.: materiali i ndërtimit, data e ndërtimit, gjatësia e regjistruar, tonazhi bruto i regjistruar, fuqia e motorëve kryesorë, kapaciteti i hambarit dhe metodat e ruajtjes së gjahut);
- d) përshkrimi i veglave të peshkimit (p.sh.: llojet, specifikimet e veglave dhe sasia).

2. Shteti i flamurit do të sigurojë informacionin e mëposhtëm:

- a) pajisjet e lundrimit dhe të përcaktimit të pozicionit;
- b) pajisjet e komunikimit dhe komunikimin ndërkombëtar në radio;
- c) madhësinë e ekuipazhit.

### Neni 5

#### **Raportimi**

Një shtet duhet të sigurojë që anijet që mbajnë flamurin e tij t'i dërgojnë administratës së tij kombëtare të peshkimit dhe, kur të jetë rënë dakord, organizatës ose dakordësimi përkatës nënrajonat

ose rajonal të menaxhimit të peshkimit, të dhënat mbi zënien dhe sforcin, duke përfshirë të dhënat mbi operacionet e peshkimit në detin e hapur, në intervalet e nevojshme kohore për të përmbushur kërkesat kombëtare dhe detyrimet rajonale e ndërkombëtare. Këto të dhëna, kur të jetë e nevojshme, duhet të transmetohen me radio, teletext, faks ose transmetim satelitor apo me mjete të tjera.

#### Neni 6

### **Verifikimi i të dhënave**

Shtetet ose, sipas rastit, organizatat ose dakordësimet përkatëse nënrajonale, ose rajonale të menaxhimit të peshkimit duhet të krijojnë mekanizma për verifikimin e të dhënave të peshkimit, të tilla si:

- a) verifikimi i pozicionit nëpërmjet sistemeve të monitorimit të anijeve;
- b) programe të vëzhgimit shkencorë për të monitoruar peshkimin, sforcot, përbërjen e zënies (speciet objekt dhe joobjekt peshkimi) dhe hollësi të tjera të operacioneve të peshkimit;
- c) raportet mbi udhëtimet e anijes, të zbarkimit dhe të transbordimit; dhe
- d) kampionimi në port.

#### Neni 7

### **Shkëmbimi i të dhënave**

1. Të dhënat e grumbulluara nga shtetet e flamurit duhet të ndahen me shtetet e tjera të flamurit dhe shtetet bregdetare përkatëse, nëpërmjet organizatave ose dakordësimeve të duhura nënrajonale ose rajonale të menaxhimit të peshkimit. Këto organizata ose dakordësime do të përpilojnë të dhënat dhe do t'i vënë ato në dispozicion në kohë dhe në një format të rënë dakord për të gjitha shtetet e interesuara, sipas kushteve të përcaktuara nga organizata ose dakordësimi, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave të papërpunuara, dhe, sa të jetë e mundur, duhet të zhvillojnë sisteme bazash të të dhënash që sigurojnë metoda efikase në të dhëna.

2. Në nivel global, mbledhja dhe shpërndarja e të dhënave duhet të kryhet nëpërmjet Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara (FAO). Kur nuk ekziston një organizatë ose dakordësim nënrajonale ose rajonale për menaxhimin e peshkimit, ajo organizatë mund të ushtrojë të njëjtin funksion edhe në nivel nënrajonale ose rajonale, me dakordësim me shtetet përkatëse.

## SHTOJCA II

### **UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PIKAVE TË REFERENCËS PARAPRAKE NË RUAJTJEN DHE MENAXHIMIN E RESURSEVE NDËRKUFITARE DHE TË RESURSEVE SHUMËMIGRUESE TË PESHQVE**

1. Një pikë referimi paraprake është një praktikë e vlerësuar, e nxjerrë nëpërmjet një procedure shkencore të rënë dakord, e cila i korrespondon gjendjes së burimit dhe të peshkimit, dhe që mund të përdoret si udhërrëfyes për menaxhimin e peshkimit.

2. Duhet të përdoren dy lloje pikash reference paraprake: pikat e referencës së ruajtjes apo kufizimit, dhe pikat e referencës së menaxhimit apo objektivit. Pikat kufizuese vendosin kufij që synojnë të kufizojnë shfrytëzimin brenda kufijve biologjikë të sigurt, brenda të cilëve resurset mund të prodhojnë rendimentin maksimal të qëndrueshëm. Pikat objektive të referencës kanë për qëllim arritjen e objektivave të menaxhimit.

3. Pikat e referencës paraprake duhet të jenë specifike për secilin resurs, për të marrë parasysh, ndër të tjera, kapacitetin riprodhues, qëndrueshmërinë e secilit resurs dhe karakteristikat e peshkimit që e shfrytëzon atë resurs, si dhe faktorët e tjerë të ngordhjes dhe burimet e mëdha të pasigurta.

4. Strategjitë e menaxhimit do të synojnë të ruajnë ose të rivendosin popullatat e resurseve të peshkuara, dhe aty ku të jetë e nevojshme, edhe speciet e lidhura ose të varura, në nivele që janë në përputhje me pikat e referencës paraprake të rëna dakord më parë. Këto pika referimi do të përdoren

për të nxitur masat e paracaktuara të ruajtjes dhe menaxhimit të paracaktuara. Strategjitë e menaxhimit do të përfshijnë masa që mund të zbatohen kur afrohen pikat e referencës paraprahe.

5. Strategjitë e menaxhimit të peshkimit do të sigurojnë që rreziku i tejkalimit të pikave kufizuese të referencës të jetë shumë i ulët. Nëse një resurs bie nën një pikë kufizuese të referencës ose është në rrezik të rënies nën një pikë të tillë, duhet të iniciohen masa të ruajtjes dhe menaxhimit për të lehtësuar rikuperimin e resursit. Strategjitë e menaxhimit të peshkimit do të sigurojnë që pikat objektive të referencës të mos tejkalojnë mesataren.

6. Kur informacioni për përcaktimin e pikave të referencës për një peshkim është i pakët ose mungon, duhet të vendosen pika referimi provizore. Pikat provizore të referencës mund të përcaktohen në analogji me resurse të ngjashme dhe më të njohura. Në situata të tilla, aktiviteti i peshkimit do t'i nënshtrohet një monitorimi të shtuar në mënyrë që të mundësohet rishikimi i pikave provizore të referencës sapo të jenë të disponueshme informacione më të përmirësuara.

7. Norma e ngordhjes së gjahut që gjeneron rendimentin maksimal të qëndrueshëm duhet të konsiderohet si një standard minimal për pikat kufizuese të referencës. Për resurset që nuk janë të mbipeshkuara, strategjitë e menaxhimit të peshkimit do të sigurojnë që ngordhja nga peshkimi të mos e tejkalojë atë që korrespondon me rendimentin maksimal të qëndrueshëm, dhe që biomasa të mos bjerë nën një prag të paracaktuar. Për resurset e mbipeshkuara, biomasa që do të prodhonte rendimentin maksimal të qëndrueshëm mund të shërbejë si një objektiv për rigjenerim.

